

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirëmbajtja dhe riparimi i elektropompave të Stacioneve të pompimit të Shoqërisë Rajonale U.K. Sarandë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e pompave

VLERA E FONDIT LIMIT:

7 086 617 (shtatë milion tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtë qind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh

Shumatorja e çmimeve për njësi është : 7 086 617 (shtatë milion tetëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtë qind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021 dhe 2022) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 30% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi : Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatimit Taksave) për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 20% të vlerës së

përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme NP.7. ”Ujesjelles, gazsjelles,vajsjelles, vepra kullimi e vaditje”, të lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Urban.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në.

Ligjin nr. 8402, date 10.9.1998 “per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” ndryshuar me: • ligjin nr. 9200, date 26.2.2004 • ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007 • ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007 • ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009 • ligjin nr. 10 324, datë 23.9.2010 • ligjin nr. 11/2012, datë 09.02.2012

VKM nr.42, datë 16.1.2008 për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

“Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.”

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Inxhinier Mekanik 1 (nje)

Inxhinier Elektrik 1 (nje)

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës **të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

1. Elektracist 1 (nje)

2. Mekanik 1 (nje)

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës **të paspecializuar**, si më poshtë

1. Punetor 2(dy)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Vertetim nga Administrata Tatimore per numrin e te siguruarve mujor,

kontrata individuale te punesimit, diplome(per inxhinieret), certificate te sigurimit teknik per inxhinieret dhe specialistet ,(leshuar nga IQT ose institucion tjeter I licensuar) dhe te figurojne ne listpagesat e muajve Prill, Maj, Qershor 2023

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Ne gjykojme se, per te kryer kete proces pune, sipas kerkesave dhe specifikimeve teknike te paracaktuara, operatori ekonomik, duhet te kete te punesuar te pakten 6(gjashte) persona.Inxhinierin Mekanik dhe Mekanikun per te vlersuar dhe kryer punimet mekanike,Inxhinierin Elektrik dhe Elektracistin, per te vleresuar dhe kryer punimet elektrike,dhe dy punetore jo domosdoshmerisht te kualifikuar,per te kryer kryesisht punet me natyre fizike. Gjithashtu, punonjesit e kualifikuar,duhet te jene te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik, sepse, do te duhet qe te punojne ne pajisje mekanike rrotulluese dhe nen ngarkese te rrymes elektrike,keshu qe duhet te jene te afte, te mbrojne veten dhe kolegun nga aksidentet ne pune.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Autovinc per nxjerrjen e pompave nga puset, me peshe ngritese minimalisht 2.5 ton

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ky lloj mjeti eshte i domosdoshem per te nxjerre dhe rifitur pompen ne pus,duke patur parasysht se peshja maksimale e pompes qe mund te defektohet dhe te nxirret, motorit,tubacionit dhe kollones se ujit shkon afersisht 2.2 ton.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me certifikatat ISO te vlefshme, si me poshte

1.Certifikate EN-ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit te cilesise/ ose ekuivalent

2. Certifikata e sistemit te menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune ISO 18001; ose ekuivalente, e vlefshme

Argumentimi: Në bazë të pikës 2,c, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që:


Te jene te pajisur me certifikate te sistemit te menaxhimit te cilesise per arsye se punimet per mirembajtjen dhe riparimin e ketyre elektropompave , per vete rendesine qe ato kane, si agregate, qe sherbejne per furnizimin me uje te popullates dhe per largimin e ujrave te ndotur,duhet te jene te nje cilesie te larte per te zgjatur periudhen e funksionimit te pavarur deri ne riparimin tjeter.

Te jene te pajisur me certifikate te sistemit te menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune,meqenese ne kete natyre pune,rrezikshmeria eshte me e larte,per arsye se kemi te bejme me punime ne pajisje te rrymes elektrike, dhe duke qene se,specialistet e ketij operatori do te punojne ne mjediset tona,se bashku me specialistet tane,ai duhet te jete i afte te mbroje jeten edhe te punonjesve tane.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

1. Informacion mbi stacionet e pompimit dhe vendndodhjen e tyre.


Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sh.A. Sarande, administron shërbimet e furnizimit me uje te pijshem dhe largimin e ujrave te ndotur ne njesite bashkiake Sarande, Delvine, Finiq dhe Konispol dhe per rrjedhim edhe stacionet e pompimit qe nevojiten per kryerjen e ketij shërbimi. Zona e rrethuar ne figuren e meposhtme eshte zona e shërbimit te shoqerise



Me konkretisht;


Njesia Sarande ka keto stacione pompimi

Vrion,Shelegar,Cuke(Radiostacioni),.Cuke,(Fshat),Manastir,26Marsi,Pema e
thate(Ksamil),Spital,Rruga Ura,Baba Rexhep, Lugu I Dardhes,Lekures,Gjashte,(Sarande) si
stacione te ujit te pijshem dhe S.P.U.N Sarande dhe stacionet nr 1.2.4.5.6 ne Ksamil si stacione te
largimit te ujrave te ndotura.



Njesia Delvine ka keto stacione pompimi

Vriza dhe Ish.Repartit Ushtarak ne Delvine dhe ne fshatrat Fushe Veri,Vergo,Kopaces,Palavli,Vllahat,Stjar,Rusan




Njesia Konispol ka keto stacione pompimi

Konispol, Ciflig,Shkalle,Mursi,Markat,Merko,Verve,Dishat,Janjar,Shales



Njesia Finiq ka keto stacione pompimi

Bregas,Vrion,Dermish,Muzine,Dhrovjan,Pece,Krongj,Livine,Karahaxh dhe Kostar



Duhet theksuar se stacionet e njesive te tjera bashkiake, pervec Sarandes, jane stacione pompimi te ujit te pijshem,

2.Kategorite e punimeve

Punimet qe do te kryhen,per mirembajtjen dhe riparimin e elektropompave,jane dy llojesh;
Punime mekanike qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e pompave.

Me konkretisht, ne keto punime perfshihen;

zmontimi i pompes nga bazamenti ose nxjerrje nga pusi,transport ne piken e servisit, demontim i vete pompes, riparim ose zevendesim i pjeses se demtuar(kushinete, bosht, permistop, bokoll,

distancator, difuzor, elike, etj), montim i pompes, risjelleje ne stacion dhe motim ne bazament ose ne pus.

Pervec ketyre, perfshihen edhe disa punime te tjera te mirembajtjes prventivuese, si grasatime kushinetash ose lubrifikim me vaj, sipas rastit,vendosje litari amianti, shtrengime bulonash, etj.

Punime elektrike, qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e elektromotoreve.

Edhe per punimet elektrike, do te ndiqet i njejti proces pune si per pompat,por per elektromotoret, eshte parashikuar kryesisht avolzhimi(ripeshtjellimi) i tyre dhe, ne disa raste, edhe zevendesimi i pjeseve te tjera te kembimit, si kushineta,permistopa,boshte etj.

3.Preventivi dhe te dhena te tjera teknike

Ne preventivin hartuar per realizimin e kesaj procedure prokurimi percaktohen; marka dhe tipi i pompes dhe i elektromotorit,numrat e pompave dhe elektromotoreve.

Ne preventiv jane te perfshira edhe punimet shtese si,demontim dhe montim i pajisjes(nxjerrje dhe rifutje ne pus),transport deri ne piken e servisit dhe risjellje,per cdo sherbim qe do te kryhet dhe do t'i kete te nevojshme keto punime.

Ne preventiv jane paraqitur punimet dhe pjeset e kembimit, qe mund te nevojiten per nje elektropompe ,te cdo marke ose te cdo stacioni pompimi, por, Autoriteti Kontraktor, ka te drejte, qe te riparoje me shume se nje pompe te se njejtës marke,mjafon qe ky punim te kryhet ne baze se vlerse se ofertuar per riparimin e kesaj pompe dhe vlera totale e punimeve ne asnje rast te mos e kaloje vleren totale te kontrates.

Pjeset e kembimit qe do te perdoren per riparimin e pompave dhe elektromotoreve, do te perferohen te jen nga prodhuesi i vete pajisjes por do te pranohen edhe ato ekuivalente.

Lubrifikantet qe do te perdoren per pompat zhytese te largimit te ujrave te ndotura do te jene vajra jo toksike tip Mercury No;7174,Merkur White oil Pharma 40 ose ekuivalent SAE 10W, SAE 20W dhe graso ESSO UNIRES N3, FAG ARCANOL L40,TEXACO HYTEC EP3/DEA Pragon ose ekuivalente me to.Sasia e lubrifikanteve dhe ftohesve, pasqyrohet ne preventiv,prandaj njesia e ketij zeri punimi pershkruhet "ls", qe do te thote se ne te permblidhet gjithë sasia e lubrifikantit dhe puna qe do te behet per t'a nderruar ate.

4.Sqarime dhe detyrime per operatorin ekonomik

Operatori ekonomik ose ofertuesi,kur te paraqese oferten e tij,duhet te kete parasysht se, cdo ze punimesh ,qe do te kryhet,ne rastet kur do te kerkoje zevendesim te pjeseve te demtuara,eshte furnizim dhe vendosje e kesaj pjese,prandaj zeri i ***punetorisë(hak pune)***,nuk do te paraqitet me vete ne preventiv.

Nga ana tjetër, operatorët ekonomikë, që do të marrin pjesë në konkurim, duhet t'ua kenë të qartë se, meqenese kemi të bëjmë me një procedurë konkurimi, që do t'i paraprijë një *marreveshje kuader*, Autoriteti Kontraktor nuk është i detyruar të kryejë çdo punim sipas zerave të preventivit, dhe të paguajë të gjithë vlerën limit të kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor do të paguajë operatorin ekonomik, për ato punë, shërbime, riparime, që do të ndodhin faktikisht.

Operatori ekonomik, është i detyruar të kryejë me cilësi të lartë dhe në kohë, çdo punim, që do t'i kerkojë autoriteti kontraktor, sipas zerave të punimeve në preventiv, brenda vlerës limit për çdo zë (njësi), që operatori ekonomik, ka ofertuar.

Për çdo punim (riparim) të kryer, operatori ekonomik duhet të leshojë një certificate garancie, me afat jo më të vogël se një vit, nga data e dorëzimit të punimit. Çdo defekt që do të ndodhë në pajisjen e riparuar, brenda periudhës së garancisë, do të riparohet nga operatori ekonomik (me vone kontraktuesi), me shpenzimet e tij.

Operatori ekonomik, duhet të marrë masa që, çdo pjesë këmbimi, të percaktuar në preventiv, në bazë të markës, tipit, apo numrit të pajisjes, të jetë në gjendje t'ua sigurojë dhe sa më shpejt. Mospasja apo mospajtimi në kohë i kesaj apo këtyre pjesëve të këmbimit, në qoftë se do të sjellë vonesa të pajustificueshme për riparimin e agregatit dhe si rrjedhim edhe të punës normale të stacionit të pompimit, do të behet shkak për zgjidhjen e njëanshme të kontratës.

5. Praktika e punimeve

Operatori ekonomik (kontraktuesi), do të njoftohet zyrtarisht (bëjnë përjashtim rastet, që do të konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor) për defektin dhe pa humbur kohë do të paraqitet me specialistet e tij pranë stacionit që do të ketë problem. Pas konstatimit, konfirmimit të defektit, nga të dyja palët, pra specialistet e tij dhe tanët, agregati i demtuar do t'i dorëzohet operatorit, me anë të një akti dorëzimi ose flete daljeje provizore.

Operatori ekonomik (me vone kontraktuesi), pasi t'ua verifikojë me në thellësi defektin, duke e zmontuar agregatin në pikën e tij të servisit, do t'i dergojë Autoritetit Kontraktor, një raport të hollësishëm teknik, ku të përshkruhen në mënyrë të detajuar defektet e ndodhura dhe sipas tij, arsyen përse kanë ndodhur dhe se bashku me të një preventive-oferte, për punimet dhe pjesët e këmbimit të nevojshme për riparim, duke iu përmbajtur rigorozisht, kushteve të parashkuara në kontratë.

Pasi Autoriteti Kontraktor, t'ua ketë miratuar këto shërbime, operatori do të vazhdojë punë, për riparimin e defektit, sipas afatit të paracaktuar. Pas perfundimit të riparimit, operatori do të kryejë testimet e nevojshme, të cilat, do t'ia paraqesë edhe Autoritetit Kontraktor dhe do t'ua montojë pajisjen në stacion. Agregati ose pajisja do të punojë në periudhë prove për 72 orë, dhe pas kesaj, do të merret në dorëzim, me një garanci, të pakten një vjeçare.

Për të gjitha këto hapa, që përshkruam më lart, autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik (kontraktuesi) do të plotësojnë një dokumentacion, i cili do të përshkruhet me hollësiht në kontratë.

Ne rastet qe, do te konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor,prioritet do t'i jepet zgjidhjes sa me shpejt te problemit, perkunder dokumentimit rigoroz te proceseve qe pershkruam me siper.Por, sidoqofte,edhe ne keto raste, per aq sa eshte e mundur, do te mbahet nje dokumentacion, i cili te deshmoje punen e kryer.

6.Afati i punimeve

Afati i kesaj marreveshjeje , do te jete **deri me 31.03.2024** nga data e lidhjes se kontrates, operatori ekonomik fitues, do te jete pergjegjes per mirembajtjen e pajisjes elektromotor pompe, sipas kushteve te parashkruara ne preventiv dhe specifikime teknike.Ndersa afati ikontratave qe do te lidhen, bazuar ne kete marreveshje, do te vendoset ne varesi te punimeve te nevojshme,per riparimin e defektit(eve) per cdo rast, ne varesi te rendesise teknologjike qe ka ky stacion pompimi,pompa e te cilit eshte defektuar, apo edhe ne varesi te periudhes kohore ne te cilin ndodh defekti(perben emergjence apo jo).

Argumentim; Specifikimet teknike jane hartuar bazuar ne nenin 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Duke qene se kjo procedure,eshte nje kontrate sherbimesh, riparimesh, mirembajtjeje, te pajisjeve ekzistuese, pra motore dhe pompa, qe jane tashme te instaluar, per te percaktuar sherbimet ne to, pra zevendesimet e pjeseve te kembimit, jemi te detyruar t'i referohemi, markave te produkteteve te tyre ,per produkte qe prodhohen ne menyre ekskluzive, vetem nga prodhuesi i agregatit te caktuar.Por sigurisht, qe do te pranohen edhe pjese kembimi te njejta nga pikepamja e karakteristikave teknike, por nga prodhues te ndryshem, pra ekuivalente, per produkte qe prodhohen edhe nga prodhues te tjere, psh, per kushinetat. Karkateristikat teknike te pompave jepen ne preventivin qe shoqeron kete procedure.

Ne specifikimet teknike, pershkruhen me hollesi edhe lubrifikantet qe, do te perdoren per keto makineri dhe pajisje, per perdorimin kryesisht te vajrave jo toksike,por edhe ne kete rast, pershkrimi eshte shoqeruar me fjalen “ekuivalente”

NJESIA E PROKURIMIT

ANILA VJERI

ALTIN MAÇI

SOVJET HABIPI